

5.02.2021

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE WEBPROM GROUP SHPK

THEMELIMI

NENI 1 – THEMELUESIT

1.1 Shoqeria WEBPROM GROUP SHPK themelohet nga:

Z. Francesko Lamce, shtetas shqiptar, lindur me 30.08.2000, banues ne Durres, mbajtes i Nr.Personal K00830077N, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar;

EMERTIMI, SELIA, FORMA LIGJORE

NENI 2 - EMERTIMI

2.1 Emertimi i shoqerise eshte "WEBPROM GROUP" SHPK (me poshte e quajtur "Shoqeria").

NENI 3 - FORMA LIGJORE

3.1 Shoqeria eshte e formes me pergjegjesi te kufizuar dhe eshte themeluar ne perputhje me legjislacionin tregtar ne Shqiperi.

3.2 Shoqeria mund te shnderrohet ne nje forme tjeter ne perputhje me legjislacionin shqiptar.

NENI 4 - BAZA LIGJORE

4.1 Shoqeria do te zhyilloje veprimtarine e saj ne perputhje me kete Akt Themelimi dhe Statut, legjislacionin tregtar dhe dispozita te tjera ligjore ne fuqi.

4.2 Per sa nuk eshte parashikuar ne kete Statut, do te aplikohen dispozitat e ligjit nr. 9901, date 14.04.2008. "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

4.3 Cdo mosmarreveshje qe mund te lind ne lidhje me zbatimin dhe/ose interpretimin e ketij Statuti, do te zgjidhet nga gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

NENI 5 - PERSONALITETI JURIDIK. KOHZGJATJA

5.1 Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne Tirane, Shqiperi.

5.2 Afati i veprimtarise se shoqerise eshte i pakufizuar.

NENI 6 - SELIA

Francesko Lamce


Francesko Lamce


6.1 Selia e shoqerise eshte ne adresen: Rruga e Kavajes, Ndertesa nr 128/18 kodi postar 1023

6.2 Shoqeria mund te hape dege, filiale apo zyra perfaqesie si brenda territorit te Shqiperise ashtu dhe jashte saj.

6.3 Shoqeria mund te marre pjese ne shoqeri te tjera Shqiptare ose te huaja qe ekzistojne ose do te krijohen ne te ardhmen.

NENI 7 - EMBLEMA. VULA

7.1 Shoqeria do te kete emblemen dhe vulen e saj. Vula do te perdoret nga administratoret e shoqerise. 7.2 Forma dhe permasat e vules do te percaktohen ne perputhje me rregullat e legjislacionit shqiptar. 7.3 Te gjitha dokumentet e shoqerise duhet te permbajne emblemen dhe vulen e saj.

NENI 8 - OBJEKTI

8.1 Objekti i veprimtarise se Shoqerise do te jete: Marketing Online, Shperndarje Wifi (me qellim reklamimi)

8.2 Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter i cili eshte ne perputhje me Ligjet e Republikes se Shqiperise.

NENI 9— KAPITALI THEMELTAR

9.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 Leke;

9.2 Kapitali themeltar perbehet nga 1 (nje) kuota.

9.3 Pjeset e kapitalit themeltar zoterohen nga ortaket ne masen si me poshte:

Z. Francesko Lamce zoteron 1 (nje) kuote me vlere norninale 100 (njqinde) Leke qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

9.4 Kapitali eshte shlyer teresisht.

9.5 Pergjegjesia e Ortakeve shtrihet der i ne vleren e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqerise.

NENI 10 - TRANSFERIMI I KUOTAVE. KUFIZIMET

10.1 Kuota e kapitalit eshte e transferueshme dhe mund te transferohet ne cdo moment sipas kushteve dhe afateve te parashikuara nga ligji shqiptar.

10.2 Vendosja e cfaredolloj barre mbi pjeset e kapitalit ne favor te paleve te treta do te lejohet vetem me pelqimin e Asamblese se Ortakeve.

ORGANET E SHOQERISE

NENI 11 - VENDIMET E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

Francesko Lamce


Francesko Lamce


11.1 Asambleja e Ortakeve ne perputhje me legjislacionin shqiptar, mund te vendose, por pa u kufizuar ne to, vendimet me poshte:

- percaktimin e politikave tregtare te shoqerise dhe mbikeqyrjen e zbatimit te tyre nga administratori ose administratoret, perfshir raportet financiare;
- zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
- miratimin e shkrirjes/bashkimit me shocieri te tjera;
- ndryshimin e statutit te shoqerise;
- ndryshimin e selise dhe te emertimit te shoqerise;
- emerimin e eksperteve kontabel te autorizuar, ne qofte se eshte e nevojshme;
- rritjen ose zvogelimin e kapitalit themeltar te shoqerise;
- shitjen ose transferimin e pjeseve te kapitalit themeltar paleve te treta;
- ristrukturimin dhe prishjen shoqerise;
- emerimin ose shkarkimin e administratorit ose adnnistratoreve te shoqerise;
- miratimin e pasqyrave financiare te shoqerise dhe raportit te administatorit(eve);
- vendimin per shperndarjen e fitimit dhe mbulimin e humbjeve transformimin e shoqerise ne forma te tjera;
- dhe cdo lende tjeter te parashikuar nga statuti ose nga ligji.

NENI 12 - ADMINISTRIMI

12.1 Administrimi i shoqerise do te kryhet nga nje ose me shume administratore qe emerohen me vendim te Asamblese se Ortakeve. Ne rast se Shoqeria do te administrohet nga me shume se nje administrator, atehere Administratoret mund ti ushtrojne kompetencat bashkerisht ose vecmasas sikurse do te percaktohet ne vendimin perkates te Asamblese se Ortakeve.

12.2 Administratori i pare i shoqerise eshte: Z. Francesko Lamce, shtetas shqiptar, lindur me 30-08-2000, banues ne Durres, mbajtes i Ni. Personal K00830077N.

12.3 Administratoreve u jepen te gjitha kompetencat e percaktuara nga legjislacioni i Republikes se Shqiperise, duke perfshire, por pa u kufizuar ne to, Administratoret jane pergjegjes per veprimtarite e meposhtme:

- drejtimin e veprimtarise se perditshme te shoqerise;
- perfaqesimin e shoqerise ne marredheniet me te tretet personalisht ose me perfaqesim:

Francesko Lamce


Francesko Lamce


- hartimin dhe mbajtjen e kontabilitetit;
- pergatitjen e dokumenteve ne emer te shoqerise sipas kompetencave qe zoteron;
- te lidhe kontrata per dhe ne emer te shoqerise me pale te treta, te punesoje dhe pushoje punmarres apo staf tjetër qe konsiderohet i nevojshem per mbarevajtjen e aktivitetit te shoqerise;
- te perfaqesoje shoqierine perpara bankave te nivelit te dyte dhe Bankes se Shqiperise si dhe te kryej cdo transakcion bankar ne emer te shoqerise;
- te ndermarre cdo veprimtari tjetër, ose biznes, ose aktivitet i cili konsiderohet i nevojshem per administrimin efikas te Shoqerise ne Shqiperi.

12.4 Mandati i administratorit do te jete i vlefshern per pese vjet me te drejte riperseritje ose deri ne castin e revokimit te tij me vendim te Asamblese se Ortakeve.

12.5 Administratori i Shoqerise mund ti transferoje cdo personi apo grupi personash te gjitha apo nje pjese te kompetencave te tij sipas ketij Statuti dhe me kushtet qe ai konsideron si te arsyeshme dhe ne cdo kohe mund te anulloje kete transferim kompetencash.

NENI 13 - VITI FINANCIAR

13.1 Viti financiar i shoqerise perputhet me vitin kalendarik, duke filluar nga 1 Janari dhe perfundon me 31 Dhjetor te cdo viti.

13.2 Perjashtimisht, viti i pare financiar i shogerisa do to filloje nga dita e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe perfundon me 31 Dhjetor te po atij viti.

NENI 14 - BILANCI. KONTABILITETI.

14.1 Bilancl vietor i shoqerise shqyrtohet nga Asambleja e Ortakeve dhe duhet te pergatitet per t'u paraqitur para organeve tatimore dhe Qendres Kombetare te Regjistrimit den i ne fund te muajit Mars te cdo viti pasardhes.

14.2 Kontabiliteti mbahet ne gjuhen dhe monedhen shqiptare si dhe sipas kerkesave te legjislacionit perkates. Per operatione te vecanta, shoqeria mund te beje veprime edhe me Hogan te veganta ne monedhe te huaj, duke bere konvertimin brenda vitit.

14.3 Shogeria mund te pranoje fonde nga institucionet financiare qe operojne ne Shqiperi ose jashte. Per kete qellim shoqeria mund te lere peng pjese te kapitalit si garanci ose mund te hipotekoje pasurite e saj te paluajtshme, vetern me vendim te Asamblese se Ortakeve.

NENI 15 - TE ARDHURAT, DIVIDENDI

15.1 Shoqeria mund te krijoje fonde rezerve per realizimin e qellimeve te aktivitetit te saj ne perputhje me kerkesat e ligjit Nr. 9901. date 14.4.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Francesko Lomse


Francesko Lomse


15.2 Fitimet qe do te rezultojne ne fund te mbylljes se cdo viti ushtrimor, pas pagimit te tatimeve, mund te ndahen nga Asambleja e Ortakeve.

15.3 Humbjet e shoqerise do te mbulohen deri ne kufirin e kapitalit themeltar dhe cdo ortak do te pergjigjet deri ne kufirin e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

NENI 16 — LIKUIDIMI

16.1 Likuidimi e Shoqerise si dhe emerimi i likuidatorit(eve) behet ne perputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar, dhe cdo ligj tjeter te zbatueshem.

NENI 17— MOSMARREVESHJET

17.1 Mosmarreveshjet qe mund te lindin midis shoqerise dhe te treteve, ne rast se nuk zgjidhen me mirekuptim do ti nenshtrohen shqyrtimit nga gjykata kompetente shqiptare.

ORTAKET

Z. Francesko Lamce



Francesko Lamce


Francesko Lamce
